

AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE**PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT
(SKEMA E VLERËSIMIT)****Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja***Sesioni I, 9 qershor 2008***Varianti B**

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen disa orientime lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në prozë dhe një në poezi.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 kërkesa.

Në vlerësimin e esesë duhet pasur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të kërkesës, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni**, se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I**Kadare****“Kush e solli Doruntinën”**

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë

Pyetja 7 **2 pikë**

- Portreti i Doruntinës ka diçka qiellore; OSE
- Ajo është ëndërr; OSE
- Ajo është si diçka që nuk i takon plotësisht as jetës as vdekjes; OSE
- Ajo nuk mund të shpjegohet me asgjë materiale të kësaj bote; OSE
- Autori thekson ngjyrën e verdhë të flokëve dhe buzët e bukura; OSE
- Autori thekson detajet më seksuale të femrës: flokët dhe buzët.

Raporti që krijon me atmosferën e përgjithshme është ai **i kontrastit**. Atmosfera është e rëndë, tragjike dhe në mes saj gjendet Doruntina e bukur, e brishtë.

- 1 pikë** Nëse tregon se si është dhënë portreti i Doruntinës.
1 pikë Nëse shpjegon raportin që ky portret krijon me atmosferën e përgjithshme.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 8 **4 pikë****Model përgjigjeje**

Figurat e stilistikës: *Krahasimi*: si mjegulla, si vesa e mëngjesit; *epitetet*: e ëmbël, e holluar, kaltëroshe; *metaforat*: e frenuar prej tij qetësisht, ajo mjegull kaltëroshe të dendësohej e të krijonte një re.

Detajet: vesa, mjegulla, reja.

Shpjegimi: Dashuria e Stresit, përqaset me fillimisht me vesën, më pas me mjegullën e në fund me renë. Ajo krahasohet me dy të parat duke na krijuar idenë e diçkaje të brishtë, ta pakapshme, eterike, si frymë. Diçka që s’kuptohej dot se çfarë ishte. Më pas krahasohet me vesën e mëngjesit duke na krijuar përfytyrimin e diçkaje të pastër, të qashtë, të freskët, të panjollë, të pamëkatë, por dhe shumë delikate. Këtë ide e përforcojnë edhe një sërë epitetesh të përdorura si: e ëmbël, e holluar, kaltëroshe.

Në një çast ajo u përpoq të merrte formë, (metafora ajo mjegull kaltëroshe të dendësohej e të krijonte një re), por ky çast nuk ndodhi dot kurrë, sepse Stresi e frenoi qetësisht ndjenjën e tij.

Nëpërmjet një **shkallëzimi** vesë, mjegull re, dashuria sa vjen dhe bëhet më qiellore, më e pakapshme.

Gjithçka në këtë përshkrim të krijon përfytyrimin e një ndjenje të bukur dhe thellësisht të vërtetë, të cilën ai e ruan me kujdes në zemër.

- 4 pikë** Nëse bën një interpretim **të plotë** duke i referuar **tri** figurave të stilistikës dhe **detajeve kyç**.
- 3 pikë** Nëse bën një interpretim **të plotë**, por i referohet **dy** figurave të stilistikës dhe **detajeve kyç**.
- 2 pikë** Nëse në interpretim përmend të paktën **dy** figura të stilistikës.
- OSE** **2 pikë** nëse në përgjigjen e dhënë i referohet vetëm figurave të stilistikës bashke me ilustrimet përkatëse, por pa interpretim.
- dhe** **1 pikë** nëse në interpretim përmend vetëm një figurë.
- OSE**
- 1 pikë** Nëse gjatë interpretimit i referohet detajeve: vesa, mjegulla, reja.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 4 pikë

Model përgjigjeje

Elemente të legjendës:

- Emri i Doruntinës dhe Kostandinit;
- dy personazhet: Doruntina dhe nëna e saj;
- mallkimi i nënës;
- ngritja nga varri e Kostandinit;
- martesë larg e Doruntinës;
- vdekja e Kostandinit tre vjet më parë;
- udha e gjatë që Doruntina bëri;
- përfundimi tragjik i dy grave.

Elemente të krijuar nga autori:

- personazhi i Stresit,
- ndihmësi,
- gruaja që ndihmon,
- hetimi që Stresi zhvillon,
- ndjenja e Stresit për Doruntinën,
- flokët e verdhë të Doruntinës, etj.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen **dy** elemente të legjendës.
- dhe** **1 pikë** nëse gjen vetëm **një** element.
- 2 pikë** Nëse gjen **dy** elemente të krijuara nga autori.
- dhe** **1 pikë** nëse gjen vetëm **një** element.
- 0 pikë** Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 10 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Tiparet: shfrytëzimi i elementeve të legjendave, rrëfimi në vetën e tretë (rrëfyesi nuk është pjesëmarrës në ngjarje), modernizimi i karaktereve letrare në mënyrën e të menduarit e të të ndjerit, riaktivizimi i fjalëve të periudhës paraturke, krijimi i fjalëve të reja me brumin e shqipes, përzierja e ligjërimeve të brendshme me fjalët e autorit, etj.

2 pikë Nëse shkruan **dy** tipare të stilit të Kadaresë që spikasjin në fragment.

1 pikë Nëse shkruan vetëm **një** tipar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Te të dy gratë theksohen sytë: Zonja mëmë ndoshta kërkon shpjegim për atë që ka ndodhur. Ajo mendon se mallkimi i saj e ka ngritur të vdekurin nga varri. Kjo i krijon një gjendje tmerri. Ideja se e bija ka ardhur me një të vdekur.

Doruntina i ka sytë pa shprehje. Lajmi se i vëllai s'është më e ka tronditur sa e ka lënë pa gojë.

Të dy gratë janë të tronditura thellësisht nga të vërteta që pohohen me sy, por që ndoshta nuk do të zbulohen kurrë. Të dy gratë përpiqen të komunikojnë me anë të syve.

2 pikë Nëse shpjegon **qartë** se ç'komunikon secila nga gratë përmes syve.

dhe

1 pikë Nëse shpjegon se ç'komunikon njëra nga gratë përmes syve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shpjegime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 12 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Stresi:

- ndjen keqardhje; OSE
- e kupton se ajo s'është më në këtë botë; OSE
- e ndjen se po e humb përgjithmonë.

Doruntina:

- Doruntinës i janë thare lotët; OSE
- Ajo është në një botë tjetër; OSE
- Është e shokuar nga trauma.

1 pikë Nëse shpjegon pse Stresi përletet.

1 pikë Nëse shpjegon pse nuk përletet Doruntina.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku të tregojë se si autori përdor teknika të tilla si: stili, figuracioni dhe detajet, për krijimin e situatës dramatike.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 hyrjen
 zhvillimin
 përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike
- ka fjalor të pasur
- stil origjinal

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm
- ka saktësi drejtshkrimore

PJESA II**Bajroni****“Shtegtimet e Çajld Haroldit”**

Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	B	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë
Pyetja 20	A	1 pikë

Pyetja 21 **4 pikë****Model përgjigjeje**

Përmes figurës së *inversionit*, poeti thekson përfytyrimin e përrenjve që zbresin nga lartësitë, me ujë të pastër, të ftohtë dhe duke rënë nga lartësia krijojnë imazhin e një vazhde të bardhë (*epiteti*- të bardhë dhe *krahasimi*: si dëbora).

Në vargun e dytë që është vazhdim i të parit përmes *epitetit*: mashkullore e kuqërreme krijohet imazhi i kontrastit, pra diçka e fortë e ndezur dhe më pas ku spikat dhe e kuqja. Ka një lojë ngjyrash ku dallojmë të bardhën dhe të kuqen dhe të krijohet ideja e një natyre madhështore.

4 pikë Nëse organizon interpretimin përmes **tri** figurave të stilistikës.

3 pikë Nëse e organizon interpretimin përmes **dy** figurave të stilistikës, por shprehet qartë dhe krijon përfytyrim **të plotë**.

2 pikë Nëse e organizon interpretimin përmes **dy** figurave të stilistikës, por krijon një përfytyrim **të pjesshëm**.

OSE

2 pikë Nëse përmend **tri** figura bashkë me ilustrimet përkatëse.

dhe

1 pikë Nëse përmend vetëm **një** figurë bashkë me ilustrimin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjen fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një koment që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Kult i natyrës;
- Kult i ndjenjës;
- Evokimi i së kaluarës;
- Jeta idilike patriarkale;
- Vendet ekzotike;
- Shfrytëzimi i gjinisë epiko-lirike;
- Gjuha figurative dhe me kontraste të forta.

2 pikë Nëse shkruan **dy** nga tiparet e romantizmit të dhëna më sipër.

dhe

1 pikë Nëse shkruan vetëm **një** tipar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjen fare.

Pyetja 23 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Figura bazë e vargut: antiteza

Interpretimi:

- Te shqiptarët gjenden të dy anët miqësi e pafund, nëse të bëjnë mik, por dhe armiçësi e madhe nëse je armiku i tyre; OSE
- Theksohet karakteri ekstrem i tyre, kontradiktor; OSE
- Theksohen dy të kundërta.

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës.

1 pikë Nëse bën një interpretim të vargut.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24**2 pikë****2 pikë**Nëse gjen **dy tipare** të karakterit të shqiptarit që shfaqen në fragment:

- Besnikëria;
- Mikpritja;
- Trimëria;
- Dashuria;
- Sakrifica.

DHE**1 pikë**Nëse gjen vetëm **një tipar**.**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25**3 pikë****Raporti:**

- Natyra është e ashpër, e rreptë, e egër, me ngjyra mashkullore dhe të tillë janë dhe njerëzit: krenarë, të patrembur, të fortë, të patundur. OSE
- Ka një lidhje të natyrshme midis natyrës dhe njerëzve. OSE
- Natyra dhe njerëzit plotësojnë njëri-tjetrin; OSE
- Natyrë e ashpër dhe njerëzit me karakter të ashpër; OSE
- Natyra është në harmoni me tiparet e njerëzve; OSE
- Në një natyrë të tillë mund të jetojnë vetëm njerëz trima dhe të fortë.

Ilustrimet:

- Shkëmbinj dhe njerëz të egër;
- Mot i rreptë dhe njerëz të rreptë;
- Ujku, shqipja sqepin mbreh, zogj, bisha dhe në anë tjetër njerëz t'egër zën' e duken;
- Mot i egër dhe njerëz të rreptë.

1 pikë

Nëse përcakton raportin midis natyrës dhe njerëzve.

2 pikë

Nëse gjen dy ilustrime që shpjegojnë këtë raport.

dhe**1 pikë** nëse gjen një ilustrim**OSE****1 pikë** nëse përcakton vetëm raportin.**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.